18233.

## AKT THEMELIMI
## I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR "KONTAKTI" SH.P.K.

**ORTAKET:**

- "Edita" s.r.l. ne Firenze Rr dei Mille nr.8 Itali, e perfaqesuar sipas prokures se posacme Nr. 29749 date 20 Tetor 1997 te Noterit Dott. Francesco Stedl, te qytetit Rignano sull'Arno nga Z. Stefano Mattei , lindur ne Firenze me 04.10.1960 dhe banues ne Vaiano (PO) rr. Di Mereto Nr.4;
- Z. Marco Goilli, lindur ne Sesto Fiorentino ( FI) me 1 Gusht 1939 dhe banues ne Sesto Fiorentino rr. Giotto Nr.53, i cili perfaqesohet sipas prokures Nr. 6434,date 16 tetor 1997 te noterit Edoardo Colono ne Prato (I), nga Z.Stefano Mattei, lindur ne Firenze me 04.10.1960, banues ne Vaiano (PO) rr. di Mereto nr.4;
- Dott. Giuseppa Mazzara lindur ne Palermo Itali me 14 Shtator 1956 dhe banuese ne Prato rr. "Montegrappa" nr.81, e perfaqesuar sipas prokures se posacme Nr. 6435,date 16 Tetor 1997 te Noterit te Pratos Edoardo Colona, Z. Stefano Mattei, lindur ne Firenze Itali me 04.10.1960 dhe banues ne Vaiano (PO) rr. di Mereto nr.4;
- Dok.Ylli Sula lindur ne Tirane, Shqiperi me 1 Gusht 1966 dhe banues ne Tirane rr. Mihal Grameno, nr.210/1;
-Znj. Arberina Grazhdani, lindur ne Korce me 26 Maj 1969 dhe banuese ne Tirane ne Rr. "Komuna e Parisit" pallatet 1 Maji 39/10;
- "Albanian Eagle" shpk ne rrugen "4 Shkurti" nr.216 Tirane, e perfaqesuar nga administratori i saj i vetem Stefano Mattei, lindur ne Firenze Itali me 04.10.1960 dhe banues ne Rr. di Mereto Nr.4 ne Vaiano (PO).

Jane marre vesh bashkarisht te themelojne nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar,SHPK, ne perputhje me Ligjen Nr.7634 te dates 19 Nentor 1992 me kushtet si vijojne:

**Neni 1**

Shoqeria qe ne vazhdim te ketij akti do te permendet shkurt"shoqeri" do te marre emrin "KONTAKTI" shpk.

**Neni 2**
**-Selia-**

Selia e shoqerise eshte caktuar ne kete adrese : Bul. "Deshmoret eKombit",pallati 97/2/14.Shoqeria mund te krijoje kudo qendra sekondare,filiale,magazina dhe dyqane.

**Neni 3**
**-Kohezgjatja-**

Kohezgjatja e shoqerise eshte deri me 31 Dhjetor 2020 dhe mund te zgjatet per nje ose me shue periudha kohore me vendim te asamblese se ortakeve.

**Neni 4**
**-Objekti i aktivitetit-**

Drejtimin direkt dhe indirekt te aktivitetit publicistik ne format e shumta te tij dhe ne menyre te vecante ne degen e botimeve te perditshme dhe atyre publike.
Drejtimin direkt dhe indirekt te aktivitetit publicistik ne format e shumta te tij dhe ne menyre te vecante ne degen e botimeve te perditshme dhe periodike.
Industrine botuese,librarine dhe shkrimet e shtypit te mesem ose sisteme te tjera te perhapjes perfshi te gjitha sistemet audiovizive.
Mund te publikoje gazeta te perditshme dhe periodike dhe drejtoje agjensi informacioni.
Mund te organizoje shperndarjen per vete dhe per te tretet te te perditshmeve e periodikeve.
Mund te zhvilloje edhe industrine e letres qe lidhet me zhvillimin e aktiviteteve ketej e tutje.

Mund te gjithashtu te ushtroje aktivitetin e tregtimit dhe sherbimit te mjeteve te informacionit te cdo lloji nga shtypi, mund te zhvilloje aktivitete per grumbullimin e publikimeve edhe per llogari te te treteve.
Si ne Shqiperi edhe jashte shtetit te gjitha operacionet qe lidhen me krijimet,prodhimin dhe tregtimin e sherbimeve mekanografike,te prodhimeve si Softwear e te ngjashme me to, te perpunimit te te dhenave per vete dhe per llogari te te treteve,krahas konsulencave,perfaqesimeve ne sektorin mekanografik ,teperpunimin ne sektorin e komunikacioneve dhe transmetimin e te dhenave e te makinerive perkatese.
Shoqeria mund te zhvilloje aktivitet te import-eksportit dhe te tregtise si me shumice epakice.
Shoqeria mund te kryeje te gjitha operacionet per pronat e luajtshme e te paluajtshme,tregtare e financiare qe do te konsideroje te nevojshme ose te pershtatshme per realizimin e objektit te aktivitetit te saj.
Mund te marre persiper dhe lejoje pjesmarrjen ne fitime,kuota ne shoqeri te krijuara ose duke u krijuar.

### Neni 5

Kapitali themeltar eshte caktuar ne shumen 100.000 (njeqind mije)leke, i cili eshte derdhur i teri prane Bankes Italo Shqiptare,Tirane.
Kapitali themeltar eshte perbere nga 100 ( njeqind)pjese te barabarta ( kuota), me nje vlere nominale 1000 (njemije) leke secila.

| | |
|---|---|
| - EDITA S.r.l. | 35 kuota per nje total prej 35 000 leke |
| - Marco Giolli | 15 kuota per nje total prej 15 000 leke |
| - Giuseppa Mazzara | 2,5 kuota per nje total prej 2 500 leke |
| - Edoardo Colonna Romano | 2,5 kuota per nje total prej 2 500 leke |
| - Ylli Sula | 15 kuota per nje total prej 15 000 leke |
| - Arberina Grazhdani | 15 kuota per nje total prej 15 000 leke |
| - Albanian Eagle shpk | 15 kuota per je total prej 15 000 leke |

### Neni 6
### -Administrimi-

Ne ushtrimet epara shoqeria do te administrohet nga nje keshill administrativ i perbere nga dy persona qe prej tashti jane emeruar:
- Dok.Ylli Sula lindur ne Tirane, Shqiperi me 1 Gusht 1966 dhe banues ne Tirane rr. Mihal Grameno, nr.210/1;
-Znj. Arberina Grazhdani, lindur ne Korce me 26 Maj 1969 dhe banuese ne Tirane ne Rr. "Komuna e Parisit" pallatet 1 Maji 39/10;
te cilet e pranojne nje detyre te tille qe do te zgjase deri me 31 dhjetor 1998 dhe qe nenkupton rinovimin nga viti ne vit.
Administratore te vecante mund te heqin dore nga detyra duke informuar me shkrim administratoret e tjere te pakten tridhjete dite perpara.
Pagesa e administratoreve do te caktohet nga asamblea e zakonshme e ortakeve.
Funksionimi i keshillit te administrimit duhet te respektoje ate cka eshte parashikuar ne statutin e shoqerise dhe ligjet ne fuqi.

**Neni 7**
**-Veprimtaria-**

Te gjitha veprimet perfshi ato te ketij viti mbyllen me 31 dhjetor.

**Neni 8**

Per sa nuk eshte parashikuar ne kete akt themelimi referimi do te behet ne normat e statutit, ligjet ne fuqi dhe si dhe ne Kodin Civil.

**Neni 9**

Ky akt themelimi permban nente nene dhe ze tre faqe te daktilografuara, ne kater kopje te barabarta.
Lexohet, aprovohet dhe nenshkruhet nga ortaket pa verejtje.
**Nenshkrues:**
**PER " EDITA " s.r.l.: Marco Giolli, Giuseppa Mazzara, Edoardo Colona Romano dhe "ALBANIAN EAGLE" shpk.**
**PERFAQESUESI I TYRE ME PROKURE TE POSACME**

**STEFANO MATTEI** ________

**YLLI SULA**

**ARBERINA GRAZHDANI**

**STATUTI**
**I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**
**"KONTAKTI" SHPK**

**ORTAKET:**

- "Edita" s.r.l. ne Firenze Rr dei Mille nr.8 Itali, e perfaqesuar sipas prokures se posacme Nr. 29749 date 20 Tetor 1997 te Noterit Dott. Francesco Stedl, te qytetit Rignano sull'Arno nga Z. Stefano Mattei , lindur ne Firenze me 04.10.1960 dhe banues ne Vaiano (PO) rr. Di Mereto Nr.4;
- Z. Marco Goilli, lindur ne Sesto Fiorentino ( FI) me 1 Gusht 1939 dhe banues ne Sesto Fiorentino rr. Giotto Nr.53, i cili perfaqesohet sipas prokures Nr. 6434,date 16 tetor 1997 te noterit Edoardo Colono ne Prato (I), nga Z.Stefano Mattei, lindur ne Firenze me 04.10.1960, banues ne Vaiano (PO) rr. di Mereto nr.4;
- Dott. Giuseppa Mazzara lindur ne Palermo Itali me 14 Shtator 1956 dhe banuese ne Prato rr. "Montegrappa" nr.81, e perfaqesuar sipas prokures se posacme Nr. 6435,date 16 Tetor 1997 te Noterit te Pratos Edoardo Colona, Z. Stefano Mattei, lindur ne Firenze Itali me 04.10.1960 dhe banues ne Vaiano (PO) rr. di Mereto nr.4;
- Dok.Ylli Sula lindur ne Tirane, Shqiperi me 1 Gusht 1966 dhe banues ne Tirane rr. Mihal Grameno, nr.210/1;
-Znj. Arberina Grazhdani, lindur ne Korce me 26 Maj 1969 dhe banuese ne Tirane ne Rr. "Komuna e Parisit" pallatet 1 Maji 39/10;
- "Albanian Eagle" shpk ne rrugen "4 Shkurti" nr.216 Tirane, e perfaqesuar nga administratori i saj i vetem Stefano Mattei, lindur ne Firenze Itali me 04.10.1960 dhe banues ne Rr. di Mereto Nr.4 ne Vaiano (PO).

Te cilet deklarojne se aprovojne kete Statut me dispozitat e meposhtme:

## KAPITULLI I
## Emertimi-Selia-Kohezgjatja-Objekti

### Neni 1
Eshte themeluar nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar e quajtur "KONTAKTI" shpk.

### Neni 2
Shoqeria formohet ne bazen e aktit te themelimit te nenshkruar dhe ne mbeshtetje te ligjit Nr. 7638 te 19 Nentori 1992 dhe te dispozitave te ligjeve ne fuqi ne Republiken e Shqiperise.

### Neni 3
Selia e shoqerise eshte caktuar ne kete adrese : Bul. "Deshmoret e Kombit",pallati 97/2/14.Shoqeria mund te krijoje kudo qendra sekondare,filiale,magazina dhe dyqane.

### Neni 4
Kohezgjatja e shoqerise eshte deri me 31 Dhjetor 2020 dhe mund te zgjatet per nje ose me shue periudha kohore me vendim te asamblese se ortakeve.

### Neni 5
Drejtimin direkt dhe indirekt te aktivitetit publicistik ne format e shumta te tij dhe ne menyre te vecante ne degen e botimeve te perditshme dhe atyre publike.
Drejtimin direkt dhe indirekt te aktivitetit publicistik ne format e shumta te tij dhe ne menyre te vecante ne degen e botimeve te perditshme dhe periodike.
Industrine botuese,librarine dhe shkrimet e shtypit te mesem ose sisteme te tjera te perhapjes perfshi te gjitha sistemet audiovizive.
Mund te publikoje gazeta te perditshme dhe periodike dhe drejtoje agjensi informacioni.
Mund te organizoje shperndarjen per vete dhe per te tretet te te perditshmeve e periodikeve.

Mund te zhvilloje edhe industrine e letres qe lidhet me zhvillimin e aktiviteteve ketej e tutje.
Mundet gjithashtu te ushtroje aktivitetin e tregtimit dhe sherbimit te mjeteve te informacionit te ndryshme nga shtypi, mund te zhvilloje aktivitete per grumbullimin e publikimeve edhe per llogari te te treteve.
Si ne Shqiperi edhe jashte shtetit te gjitha operacionet qe lidhen me krijimet,prodhimin dhe tregtimin e sherbimeve mekanografike,te prodhimeve si Softwear e te ngjashme me to, te perpunimit te te dhenave per vete dhe per llogari te te treteve,krahas konsulencave,perfaqesimeve ne sektorin mekanografik ,teperpunimin ne sektorin e komunikacioneve dhe transmetimin e te dhenave e te makinerive perkatese.
Shoqeria mund te zhvilloje aktivitet te import-eksportit dhe te tregtise si me shumice epakice.
Shoqeria mund te kryeje te gjitha operacionet per pronat e luajtshme e te paluajtshme,tregtare e financiare qe do te konsideroje te nevojshme ose te pershtatshme per realizimin e objektit te aktivitetit te saj.
Mund te marre persiper dhe lejoje pjesmarrjen ne fitime,kuota ne shoqeri te krijuara ose duke u krijuar.

## KAPITULLI II
## KAPITALI THEMELOR
### Neni 6

Kapitali themeltar i shoqerise do te jete 100000(njeqind mije)leke, i cili eshte derdhur i teri prane Bankes Italo Shqiptare,Tirane.
Kapitali themeltar eshte perbere nga 100 ( njeqind)pjese te barabarta ( kuota), me nje vlere nominale 1000 (njemije) leke secila.

### Neni 7

Çfaredolloj transferimi i kuotave shoqerore, teresore apo te pjeseshme, ndermjet ortakeve ose me te tretet, mund te realizohet vetem me akt noterial, dhe ne çdo rast ortaket proporcionalisht me kuotat qe posedojne kane te drejten e perparesise.
Ortaku apo ortaket qe duan te shesin kuotat e veta te kapitalit shoqeror duhet te komunikojne me ortaket me shkrim, telegram ose me leter rekomande me fature marrje, ku te tregohen kushtet e dhenies. Neqoftese brenda 30 ( tridhjete) diteve nga data e njoftimit ortaket nuk transmetojne, me te njejten forme, pranimin e blerjes, ortaku qe jep kuotat, rezervon te drejten e kalimit te kuotave te treteve.
Ne rast te kundert kuotat do te ndahen ndermejt ortakeve qe kane pranuar blerjen ne proporcionet e kuotave qe posedojne. Ne rast se pranon vetem nje ortak, ai mund te ushtroje te drejten mbi te gjitha kuotat ne shitje.

### Neni 8

Shtimi i kapitalit mund te vendoset nga asamblea e ortakeve ne mbledhie te jashtezakoneshme.
Shtimi i kapitalit shoqeror mund te kryhet me derdhje ne para, tituj krediti si dhe ne natyre, menyrat duhet te percaktohen nga asamblea e ortakeve. Shtimi i vendosur duhet t'u ofrohet si mundesi ortakeve ne proporcion me kuotat qe posedon secili.

## KAPITULLI III
## ASAMBLEA
### Neni 9

Asamblea e ortakeve ne mbledhje te jashtezakonshme mund te zvogeloje kapitalin themelor.

### Neni 10

Asamblea e ortakeve eshte e jashtezakonshme kur rendi i dites parashikon nje nga pikat e meposhtme:
a- modifikimin e Statutit
b-shtimin ose zvogelimin e kapitalit shoqeror;

c-venien ne likuidim te shoqerise;
d-kerkese ose dhenie financimesh;
e-shitje ose blerje te pasurive te paluajtshmesh;
f-pjesmarrjen ne shoqeri te tjera;
Asamblea e jashtezakonshme mund te marre çfaredolloj vendimi mjafton qe te jete ne perputhje me ligjet ne fuqi.
Vendimet e marra nga asamblea e jashtezakonshme konsiderohen te vlefshme, neqoftese merren nga te pakten dy te tretat e kapitalit shoqeror.

**Neni 11**

Asamblete konsiderohen te zakonshme kur ne rendin e dites nuk futen çeshtjet e nenit 10 te ketij statuti; asamblea e zakonshme duhet te thirret te pakten nje here ne vit, ne kater muajt e pare te vitit.
Vendimet e marra nga asamblete e zakonshme konsiderohen te vlefshme, neqoftese merren te pakten nga 51% ( pesedhjete e nje) te kapitalit themeltar.

**Neni 12**

Asamblea duhet te thirret nga administratori ose nga organi administrativ nepermjet telegramit, faks ose me leter rekomande me fature marrje, te pakten njezet dite perpara, ku te jene te percaktuara rendi i dites, data, ora dhe vendi.
Neqoftese me thirrjen e pare nuk arrihet shumica e nevojshme per te marre vendime, per shkak te mungeses se nje pjese te kapitalit themeltar, asamblea shtyhet ne nje thirrje te dyte dhe mund te marre vendime me perqindjen e parashikuara te kapitalit shoqeror te pranishem.
Asamblete jane te vlefshme edhe kur mbahen pa paralajmerim kur ne to merr pjese teresia e kapitalit themeltar.
Ne asamblete çdo ortak mund te perfaqesohet nga persona te tjere, ortake ose jo ortake, me anen e nje delegimi me shkrim.

## KAPITULLI IV
## ADMINISTRIMI

**Neni 13**

Shoqeria mund te administrohet nga nje person unik ose nga shume administratore deri ne nje maksimum prej pese vetash , ortake ose jo ortake, te zgjedhur per here te pare ne aktin e themelimit dhe ne vazhdim nga asamblea e zakonshme e ortakeve.
Administratori ose Keshilli Administrativ, qendron ne detyre nje vit, asamblea e ortakeve ka fuqi te rinovoje detyren dhe revokoje ate edhe para afatit.
Ne rastet kur shoqeria administrohet nga nje keshill administrativ,anetaret e tij ne mbledhjen e pare zgjedhin kryetarin e ketij keshilli.
Shperblimi i administratorit ose i administratoreve te ndryshem, do te percaktohet per here te pare ne aktin e themelimit dhe ne vazhdim nga asamblea e zakonshme e ortakeve.

**Neni 14**

Administratorit ose Keshillit Administrativ i jepen te gjitha fuqite per administrimin e zakonshem dhe te jashtezakonshem te shoqerise per permbushjen e te gjitha akteve qe parashikon objekti shoqeror, duke pasur ne kompetence çdo gje qe nga Ligjet dhe nga Statuti nuk i rezervohen shprehimisht kompetences se asamblese se ortakeve.

**Neni 15**

Ne rast se shoqeria administrohet nga nje Keshill Administrativ, ajo mund te thirret me kerkesen e thjeshte te njerit prej administratoreve, me faks, telegram ose me rekomande me deftese marrje, te pakten pesembedhjete dite perpara. Asamblea eshte e vlefshme kur ne te marrin pjese te pakten dy te tretat keshillit administrativ, vendimet jane te vlefshme kur arrihet mendimi i perbashket i te pakten dy keshilltareve.
Asamblea e ortakeve si dhe Keshilli Administrativ mund te jape delegime te veçanta keshilltareve te ndryshem.

**Neni 16**

Administratori ose administratoret jane pergjegjes kundrejt shoqerise ose te treteve per shkelje te mundshme te ligjeve ose te ketij Statuti si dhe per shkelje te renda te te fajshme,te kryera gjate administrimit te shoqerise.

## KAPITULLI V
## Pakte te ndaluara
### Neni 17

I ndalohet rreptesisht shoqerise t'ju jape hua administratoreve dhe ortakeve, siç i ndalohet edhe t'i garantoje te tretet per huate te dhena ketyre persona, me cilesine personale.

## KAPITULLI VI
## Mbajtja e Kontabilitetit- bilanci- ndarja e te ardhurave
### Neni 18

Mbajtja e kontabilitetit duhet te behet nga nje ekspert kontabel, i cili krahas respektimit te ligjeve fiskale duhet te zoteroje edhe tekniken e partise dyfishe.

### Neni 19

Veprimtaria shoqerore mbyllet me 31 Dhjetor te çdo viti.

Ne fund te veprimtarise se çdo viti administratori ose organi admnistrativ duhet te beje bilancin dhe llogarine e te ardhurave dhe te humbjeve ne perputhje me ligjet.

### Neni 20

Te ardhurat neto qe rezultojne nga bilanci,te aprovuara rregullisht nga asamblea e zakonshme e ortakeve, do te ndahen ndermjet ortakeve ne proporcion me kuotat respektive, me perjashtim te vendimeve te marra nga asamblea ndryshe.

## KAPITULLI VII
## Shuarja dhe Likuidimi
### Neni 21

Ne rast te prishjes se shoqerise, asamblea e ortakeve ne mbledhje te jashtezakonshme percakton menyrat e likuidimit dhe emeron nje ose me shume likuidatore duke percaktuar kompetencat e tyre.

## KAPITULLI VIII
## Arbitrimi - Referimi
### Neni 22

Mosmarreveshjet qe mund te lindin ndermjet shoqerise dhe ortakeve dhe ndermejt vete ortakeve, ose te treteve qe kane lidhje me ortakun dhe shoqerine, ne lidhje me interpretimin dhe zbatimin e ketij statuti, perjashto ato qe jane kompetence e veçante e Autoriteteve Gjyqesore,nga njera pale duhet t'u komunikohet pales tjeter ose paleve te tjera me telegram ose leter rekomande; keto mosmarreveshje do t'i besohen gjykimit te nje arbitri te vetem, emerohet nje keshill i perbere nga tre arbitra dashamires,te cilet do te vendosin me drejtesi dhe pa respektuar normat e procedures,te emeruar nga secila pale ( neqoftese palet ne konflikt jane dy) dhe i treti, qe do te kryeje funksionet e kryetarit te keshillit. Zgjedhja do te behet me marreveshje te perbashket nga dy arbitrat e emeruar si te tille, brenda dhjete diteve nga emerimi i arbitrit te dyte, dhe ne rast mosmarreveshje, nga Gjykata e rrethit, me kerkesen edhe te nje pale te vetme, e cila do te emeroje edhe arbitrin per palen ne konflikt qe nuk ka paraqitur arbitrin e saj 30 ( tridhjete) dite nga njoftimi i lindjes se çeshtjes.

Neqoftese palet ne konflikt jane me shume se dy, dhe mungon unanimiteti per zgjedhjen e arbitrit unik, te tre anetaret e Keshillit arbitror do te emerohen nga Gjykata e Rrethit.

Arbitri unik ose keshilli arbitrar do te gjykoje ne menyre dashamirese dhe me drejtesi, ne menyre te paapelueshme, pa asnje formalitet procedure, me perjashtim te lajmerimit me shkrim te paleve ne gjykim dhe te atyre te kerkuara nga ligji ne menyre absolute.

### Neni 23

Perçfare nuk eshte parashikuar shprehimisht ne kete statut do t'i referohet Ligjeve te Republikes se Shqiperise.

Ky statut permban 23(njezetetre) te shkruara ne pese(5) flete te daktilografuara me mjet elektronik dhe permbajtie te njejte ne kater kopie.

Tirane me____.___.1997

**Nenshkrues:**

**PER " EDITA " s.r.l.: Marco Giolli, Giuseppa Mazzara, Edoardo Colona Romano dhe "ALBANIAN EAGLE" shpk.**

**PERFAQESUESI I TYRE ME PROKURE TE POSACME**

**STEFANO MATTEI**

**YLLI SULA**

**ARBERINA GRAZHDANI**